

Vendim nr. 271 datë 12.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 12.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: KRISTAQ MINGA, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi Kosta Jani.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1886, datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shkelja e detyrimit kushtetues për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Mosrespektimi i të drejtave të mia themelore kushtetuese dhe mospërmbushja e detyrimit kushtetues për të kontribuar në realizimin e të drejtave që i kam fituar nëpërmjet vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 420, datë 08.09.2015, i cili ka shpallur absolutisht të pavlefshëm aktin nr.12, datë 10.02.2015 për pezullimin tim nga puna, në dispozitivin e të cilit urdhërohet kthimi im në pozicionin e mëparshëm të punës pranë këshillit të qarkut Korçë, vendim i paekzekutuar nga institucioni. Në kundërshtim me dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nuk konstatoi pavlefshmërinë absolute të aktit antikushtetues nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë për lirimin tim nga puna, akt që doli në kundërshtim me vendimin gjyqësor të formës së prerë, për të penguar ekzekutimin

e tij, akt që ka dhunuar, tjetërsuar dhe nuk ka respektuar të drejtën time kushtetuese për të shijuar qëllimin e drejtësisë, për të cilën kam investuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë të sipërcituar. Në këtë vendim ka shkelje të detyrimit kushtetues për shqyrtimin e çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit të zbatuar keq nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin antikushtetues nr. 3519, datë 14.07.2017, për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe për gjykimin sërish. Zgjidhja e pasojave konform vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 420, datë 08.09.2015.

Shkelja e parimit të organit përfaqësues të këshillit të qarkut.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, pika 1, 15, 18, pika 1, 34, pika 2, 42, pika 1, 43, 44, 110, pika 3, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141, 142, pika 3 dhe 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kristaq Minga ka qenë në marrëdhënie pune pranë këshillit të qarkut Korçë në pozicionin “përgjegjës” i Seksionit të Planifikimit Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban të Territorit.

2. Me vendimin nr.1, datë 29.01.2015, kryesia e këshillit të qarkut Korçë ka autorizuar kryetaren e këshillit të hartojë strukturën organizative të këtij institucioni dhe me urdhrin nr.12, datë 10.12.2015 të kryetares së këshillit të qarkut Korçë është urdhëruar pezullimi i kërkuesit nga detyra për shkak të ligjit, pas konstatimit të shkakut të pezullimit nga njësia përgjegjëse. Me aktin e konstatimit nr.223 prot., datë 06.02.2015, komisioni i ristrukturimit ka konstatuar ekzistencën e shkaqeve të pezullimit nga detyra të kërkuesit. Me vendimin nr.223/1 prot., datë 06.02.2015 të njësisë përgjegjëse pranë këshillit të qarkut Korçë është vendosur pezullimi nga detyra i kërkuesit.

Procesi i parë gjyqësor i lidhur me shfuqizimin e urdhrin nr.12, datë 10.12.2015 të kryetares së këshillit të qarkut Korçë për pezullimin nga detyra

3. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, urdhri nr.12, datë 10.02.2015, të kryetares së këshillit të qarkut Korçë, të vendimit nr.1, datë 29.01.2015 të kryesisë së qarkut Korçë dhe të akteve nr.223 dhe nr.223/1, datë 06.02.2015, të sipërcituara.

4. Me vendimin nr.420, datë 08.09.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.223/1, datë 06.02.2015 të Njësisë Përgjegjëse pranë Këshillit të Qarkut Korçë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr.12, datë 10.02.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë. Detyrimin e palës së paditur të rimarrë në punë paditësin Kristaq Minga në pozicionin e mëparshëm të punës... Detyrimin e palës së paditur t`i paguajë paditësit Kristaq Minga pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në rimarrjen në punë. Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori pala e paditur në gjykim pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Kristaq Minga shumën përkatëse monetare të pagës që do të përfitonte që nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Kristaq Minga pas çdo muaji pas kësaj date, shumën e pagës mujore të paditësit, deri në rimarrjen e tij në detyrën e mëparshme. Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor...”*. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 06.10.2015.

5. Pas marrjes formë të prerë të vendimit, kërkuesi i është drejtuar përmbaruesit gjyqësor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm.

6. Në lidhje me veprimet e përmbaruesit gjyqësor kërkuesi ka pasur pretendime për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, ndaj i është drejtuar edhe Gjykatës Kushtetuese

(Gjykata) me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm si rrjedhojë e vonesës në ekzekutimin e vendimit, e cila, pasi e ka shqyrtuar çështjen në Kolegj, me vendimin nr. 19, datë 19.12.2019, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Procesi objekt shqyrtimi lidhur me shfuqizimin e vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë për përfundimin e marrëdhënieve në Shërbimin Civil

7. Kërkuesi, me shkresën nr.1371 prot., datë 17.11.2015, është njoftuar që të paraqitej në këshillin e qarkut Korçë në datën 19.11.2015 dhe në po këtë datë ai është njoftuar se do të largohet nga puna për arsye të ristrukturimit të institucionit dhe shkurtimeve të vendit të punës në organikën e re të miratuar me vendimin nr.32, datë 25.03.2015 të po këtij këshilli. Me vendimin nr.11, datë 23.11.2015, të po atij organi, është vendosur përfundimi i marrëdhënieve në Shërbimin Civil të kërkuesit, i cili i është drejtuar sërish gjykatës me padi për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ dhe detyrimin e palës së paditur ta rikthejë në punë. Konkretisht, kërkuesi ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimi nr.11, datë 23.11.2015, të këshillit të qarkut Korçë, detyrimin e palës së paditur ta kthejë kërkuesin në detyrë, si dhe detyrimin e palës së paditur të marrë në dorëzim arkivin urbanistik të qarkut Korçë.

8. Me vendimin nr.(462)-1180, datë 14.10.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë dhe detyrimin e palës së paditur të rimarrë në punë paditësin Kristaq Minga në pozicionin e mëparshëm të punës. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Kristaq Minga pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në rimarrjen e tij në punë. Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori palë e paditur në gjykim pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Kristaq Minga shumën përkatëse monetare të pagës që do të përfitonte paditësi që nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Kristaq Minga pas çdo muaji të kësaj date shumën e pagës mujore të paditësit, deri në rimarrjen në detyrën e mëparshme. Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera...”*. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim këshilli i qarkut Korçë.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3519, datë 14.07.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.(462)-1180, datë 14.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit, duke argumentuar se akti i

kundërshtuar nga kërkuesi nuk përmbante asnjë nga elementet e pavlefshmërisë absolute. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1886, datë 09.05.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në rekurs nuk ishin ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

11. Në datën 09.09.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Në datën 03.10.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për shtesa në objekt, në bazë ligjore, në pretendimet dhe argumentet e tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

12.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, pasi të gjitha faktet e parashtruara në kërkesë lidhur me vendimmarrjen e gjykatave tregojnë për një proces të parregullt ligjor.

12.2. *E drejta për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike*, të parashikuar nga neni 4, pika 1 dhe 142 pika 3, të Kushtetutës, pasi moskonstatimi i pavlefshmërisë absolute nga ana e gjykatave të vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë, si një akt i nxjerrë për të penguar ekzekutimin, bie në kundërshtim me dispozitivin e vendimit nr. 420, datë 08.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i cili nuk është ekzekutuar nga organet kompetente. Mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë bie ndesh edhe me parimin e sigurisë juridike, mbrojtjen e të drejtave të fituara, si dhe pritshmëritë e ligjshme, si elemente të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës.

12.3. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 141 të Kushtetutës, për sa u takon çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe ka vënë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

12.4. *Parimi ne bis in idem*, të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës, pasi askush nuk mund të gjykohet sërish. Ndërkohë që i është pranuar padia për urdhrin nr.12, datë 10.02.2015 të kryetares së këshillit të qarkut Korçë, institucioni ka nxjerrë aktin tjetër objekt gjykimi (vendimi nr.11, datë 23.11.2015 i këshillit të qarkut Korçë),

duke e liruar nga detyra pa ekzekutuar më parë vendimin nr. 420, datë 08.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

12.5. *Parimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë përpara ligjit*, i parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi duke mos arritur të marrë drejtësi për shkak të mosrespektimit të ligjit nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, është ndjerë i pabarabartë përpara ligjit dhe i diskriminuar.

12.6. *E drejta për t'u rehabilituar dhe zhdëmtuar*, e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si pasojë e efekteve negative të drejtpërdrejta për të dhe familjen e tij.

12.7. *Parimi i organit përfaqësues të këshillit të qarkut Korçë*, pasi akti i lirimimit të tij nga detyra është bërë nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të këtij institucioni, çka në vetvete e bën aktin absolutisht të pavlefshëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Në këtë këndvështrim, kërkuësi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

16. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim

përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuesi i ka parashtruar pretendimet e tij në formë dhe përmbajtje në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 09.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 09.09.2024. Gjithashtu, kërkuesi në datën 03.10.2024 ka paraqitur në Gjykatë shtesa në objekt, në bazë ligjore, në tekst, si dhe dy pretendime të reja që lidheshin me cenimin e parimit të organit përfaqësues të këshillit të qarkut Korçë dhe të parimit të sigurisë juridike.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nga përmbajtja e kombinuar e neneve 1, pika 2 dhe 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, si dhe nenit 185, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se kërkuesi, në çdo fazë të gjykimit kushtetues, ka të drejtë të shtojë objektin e ankimit kushtetues individual, por pa ndryshuar njëkohësisht edhe shkaqet e tij (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkimet për cenimin e parimeve të organit përfaqësues të këshillit të qarkut Korçë dhe të sigurisë juridike shtojnë njëkohësisht objektin dhe shkaqet e ankimit fillestar, duke përbërë çështje të re.

20. Për të vlerësuar nëse kërkesa fillestare që mban datën 09.09.2024, si dhe kërkesa shtesë e paraqitur në datën 03.10.2024 janë paraqitur respektivisht brenda afatit ligjor, i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin vendimi objekt ankimi është bërë i disponueshëm për palët. Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi 00-2024-1886, datë 09.05.2024 i Kolegjit Administrativ është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 08.07.2024, për rrjedhojë të dyja kërkesat legjitimohen *ratione temporis*.

21. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka pretenduar cenimin e : (i) së drejtës për një proces të rregullt ligjor; (ii) së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të lidhur me cenimin e parimit të

sigurisë juridike; (iii) cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj për shkelje të nenit 141 të Kushtetutës; (iv) parimit ne bis in idem; (v) parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit; (vi) së drejtës për t'u rehabilituar dhe zhdëmtuar; (vii) parimit të organit përfaqësues të këshillit të qarkut Korçë.

22. Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe e bazon kërkesën e tij në faktin se të gjitha të dhënat tregojnë për një proces të parregullt ligjor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme. Megjithatë, Kolegji vëren se edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe ato për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si pasojë e shkeljes së nenit 141 të Kushtetutës, zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, bëjnë pjesë të procesi i rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës.

23. Për sa më sipër, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike me argumentin se moskonstatimi i pavlefshmërisë absolute nga ana e gjykatave të vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë, si një akt i nxjerrë për të penguar ekzekutimin, bie në kundërshtim me dispozitivin e vendimit nr.420, datë 08.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i cili nuk është ekzekutuar nga organet kompetente.

24. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se në këtë ankim kushtetues individual, nga ana e kërkuesit kundërshtohet procesi i përmbyllur me vendimin nr. 00-2024-1886, datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka si objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë. Kërkuesi pretendon se moskonstatimi i pavlefshmërisë absolute nga ana e gjykatave, të vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë (në procesin objekt shqyrtimi), si një akt i nxjerrë për të penguar ekzekutimin, ka cenuar të drejtën për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të dhënë në procesin pararendës nr. 420, datë 08.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

25. Duke analizuar këtë kërkim, Kolegji konstaton që pavarësisht se formalisht, kërkuesi e lidh moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 420, datë 08.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me procesin objekt shqyrtimi, ky ekzekutim vendimi, nuk ka lidhje me këtë proces, por me procesin pararendës, me të njëjtat palë, të ndjekur prej tij dhe që nuk është objekt i këtij ankimi kushtetues individual. Gjithashtu, lidhur me ekzekutimin e vendimit nr. 420, datë 08.09.2015, kërkuesi është në një proces tjetër gjyqësor i cili pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë me objekt: *“Kundërshtimin e refuzimit të veprimeve nga përmbaruesi gjyqësor dhe detyrimin për vazhdimin e procedurave për*

ekzekutimin e vendimit të formë së prerë.”. Në këtë kontekst, objekti i padisë së procesit gjyqësor objekt shqyrtimi është konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimit nr.11, datë 23.11.2015 të këshillit të qarkut Korçë, detyrimi i palës së paditur të kthejë kërkuesin në detyrë, si dhe detyrimi i palës së paditur të marrë në dorëzim arkivin urbanistik të qarkut Korçë, gjykim ky që nuk ka në objekt asnjë kërkesë lidhur me ekzekutimin e vendimit të pretenduar nga kërkuesi. Për sa më sipër, Kolegji çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

26. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se askush nuk mund të gjykohet sërish sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kushtetutës. Kolegji vëren se pavarësisht mënyrës se si është pretenduar nga kërkuesi, ky pretendim lidhet me cenimin e parimit “*ne bis in idem*”, të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës, i cili lidhet vetëm me proceset penale, ndërkohë që procesi i kërkuesit është i natyrës administrative, për rrjedhojë Kolegji çmon se edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

27. Po kështu, një tjetër pretendim i kërkuesit është edhe ai për cenimin e parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi duke mos arritur të marrë drejtësi për shkak të mosrespektimit të ligjit nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është ndjerë i pabarabartë përpara ligjit dhe i diskriminuar. Edhe për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të tij, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Nga ana e kërkuesit është pretenduar edhe cenimi i parimit të organit përfaqësues të këshillit të qarkut, pasi akti i lirim të tij nga detyra është bërë nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të këtij institucioni, çka në vetvete e bën aktin absolutisht të pavlefshëm.

29. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon këtij pretendimi, nga argumentet e dhëna, në thelb, kërkuesi ngre çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, ndërkohë që nuk ka arritur të sjellë ndonjë

argument kushtetues lidhur me këtë pretendim, pra të provojë cenimin e ardhur në të drejtat e tij kushtetuese. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

31. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u rehabilituar dhe zhdëmtuar, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si pasojë e efekteve negative të drejtpërdrejta për të dhe familjen e tij.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta kushtetuese për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, ka si parakusht logjik dhe juridik të saj paligjshmërinë e veprimit dhe mosveprimit të organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 27.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese se gëzon një të drejtë të njohur me ligj ose vendim gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi i tij për cenimin e së drejtës për t'u rehabilituar, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, nuk gjen mbështetje në këndvështrimin kushtetues.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.